

Akademik Ali ALIU, Prishtinë

DY VIZIONE PËR SKËNDERBEUN*

Historia e Skënderbeut, a është një mit apo një fakt historik, do të jetë njëra nga pyetjet që Fan Noli ia shtron vetes para se t'i rreket punës në shkrimin e veprës monumentale mbi Skënderbeun. Kjo është çështje nga e cila duhet nisur, beson ai, që të mund të ecet më tej drejt së vërtetës. Në këtë frymë dhe përballë kësaj pyetjeje sfiduese, Fan Noli do të shtjellojë variacione hamendsuese, gjithnjë në mbështetje të argumenteve të dokumentuara: "Historia e Skënderbeut" mund t'i ngjajë edhe një tregimi të pabesueshëm, mbase në frymën e një legjende... Dy historianët e parë të Skënderbeut, shqiptarët Anonimi i Tivarit dhe Marin Barleti, janë panegjiristë, mendon Noli, edhe pse glorifikimet e tyre janë të kontrollueshme për historianët e vërtetë, të cilët, veprën e dy panegjiristëve e vënë përballë burimeve historike të besueshme...

Por a është vërtet rrëfimi për Heroin tonë kombëtar tregim i pabesueshëm? Edhe po të përpiqemi ta zhveshim atë nga të gjitha glorifikimet lidhur me jetën dhe bëmat e Skënderbeut, në mënyrë që të mbetet vetëm skeleti i qëndrueshëm i kësaj historie, përkatësisht po të provojmë t'i lëmë të paprekura vetëm dëshmitë për të cilat tanimë nuk ka dilemë, meqë ka mbështetje të sigurt faktike, do të kemi këtë pasqyrë: Skënderbeu, në vitin 1443 e vuri në dorë Kështjellën e Krujës dhe e mbrojti atë për një çerek shekulli nga sulmet dhe rrethimet e ushtrisë më të fortë të kohës dhe nga dy sulltanët më të egër të Perandorisë Osmane. Mjafton vetëm kaq, përkatësisht vetëm kjo e dhënë, për të nxitur dhe për të justifikuar frymëzimin glorifikues të

* Kumtesë e mbajtur në Simpoziumin Shkencor "Gjergj Kastrioti Skenderbeu dhe epoka e tij", Prishtinë 21 nëntor 2005.

biografëve. Pikërisht kjo frymë entuziazmi dhe admirimi i ka përkushtuar veprat e shumicës së autorëve që janë marrë me veprën e Skënderbeut gjatë pesë shekujve...

Le të mos besojmë se numri i ushtarëve të Perandorisë Osmane ka qenë dhjetë herë apo edhe njëzet herë – sipas disa historianëve, më i madh nga numri ushtarëve të Skënderbeut, por s'ka si të mos besojmë se ai numër ka qenë gjithsesi disa fish më i madh dhe më i pajisur me përgatitje luftarake... Vetë e dhëna e padyshimtë se në dy nga këto beteja, në krye të ushtarëve osmanë kanë qenë dy sulltanët, me synim që ta pushtojnë Krujën, që megjithatë nuk mundën ta realizojnë, mjafton për të qenë *“tregim i pabesueshëm”*. Si i ka shkuar për dore kjo *“bëmë e pabesueshme”* Skënderbeut?

Natyrisht, kufijtë mes mitit dhe historisë janë vendosur moti nga shkenca zyrtare, edhe pse shumë mendimtarë i relativizojnë ato, e ka edhe të atillë që i kontestojnë. Miti është histori në vete, por njëkohësisht pjesë e historisë, mbamendjës dhe përvojës njerëzore. Në momente të caktuara, miti, sikur është më këmbëngulës si prani brenda një realiteti, sidomos brenda një realiteti i cili e ka të vështirë të ikë e të mbrohet njeriu. A është miti i pranishëm në figurën e Skënderbeut? Historianët, përkatësisht kronistët e kohës së tij thonë, bie fjala, se ai ka qenë shtatshkurtër, ndërkaq në vizionin tonë, gjatë shekujve ai nuk pushon të ketë përmasat e një vigani, përmasat madhështore me të cilat ka nevojë të ushqehet identiteti i rrezikuar njerëzor e kombëtar. Historianët thonë se fuqia e tij ka qenë përmasash normale, e njeriut të rëndomtë. Në imagjinatën tonë, ndërkaq, ai lufton me shpatën e cila është e palëvizshme për krahun e njeriut... Dhe, pse historia që, përsëri sipas një pjese të mendimtarëve është fushë interpretimi e përcaktuar nga kontekste të caktuara ideologjike, pra pse ajo do të ishte më e besueshme ta zëmë nga epet, legjendat, apo gojëdhënat?

T'i kthehemi përsëri pyetjes Noliane: Ç'është ajo fuqi që Skënderbeun nuk e la të zhvishet nga miti? Cilat janë ato hiperbola, ato figura dhe metafora që përmes imagjinatës e sqarojnë esencën e domethënies së fakteve historike? Pikërisht kjo drejtpërdrejtshmëri dhe rezonancë motive e shkëlqimit mitik të heroit tonë më të madh, si një ndjenjë e imja e ngahershme për simbolin tradicional heroik i cili është vendosur pothuaj përtej mundësive të përcaktimit apo interpretimit, për simbolin i cili sikur është një dritare e atypëratyshme për t'i prekur përmasat e madhështisë njerëzore pafundësisht në kohë,

pikërisht kjo ndërlidhje e ekzistencës së sotme me të kaluarën, ishte ngasje përsiatjesh të këtij shkrimi.

Pra, shikuar nga kjo perspektivë e zhvillimit të kulturës shpirtërore, faktet historike për heroin tonë kombëtar, natyrisht duke ofruar të dhëna konkrete, edhe pse e mbushin vakumin e mos informimit, por megjithatë nuk arrijnë t'i zbërthejnë disa faktorë që ndërlidhen drejtpërsëdrejti me idetë dhe veprimet e tija individuale. Për një historian, veprimet janë kushtëzuar nga rrethanat e caktuara dhe ngjarjet historike si rrjedhojë e njëra - tjetrës dalin të paevitueshme.

Kërshëria ngasëse drejt të kuptuarit e këtij misteri të domethënies simbolike të qëndrueshme nëpër kohë, domosdoshmërisht të shpie dhe të vë përballë vizionit të Skënderbeut, vizionit të luftës dhe të paqes. Fronti i kësaj lufte synonte përmasa universale. Në atë front ai, përveç princërve shqiptarë, përfshiu edhe ndonjë nga princërit e vendeve fqinje të shqiptarëve. Skënderbeu kërkonte në mënyrë të ethshme aleanca me princërit e Ballkanit dhe me shtetet e Evropës, për t'i dalë përpara dhe për ta ndalur vërshimin e pushtuesit që këmba – këmbës po e vinte në dorë një pjesë të Evropës. Ajo ishte një luftë e humanistit dhe e vizionarit që në emër të mbrojtjes së lirisë dhe të qytetërimit synoi të bashkojë Ballkanin dhe Evropën, ishte vizion i luftës së një strategu të udhëhequr nga largpamësia profetike e atij që ëndërronte integrim të këtyre vlerave në Ballkan dhe në Evropë. Atë që, madje, edhe në fillim të mileniumit të ri, Ballkani dhe Evropa vazhdojnë ta shfaqin si synim retorik, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu e kishte zbatuar në vepër. Besoj thellësisht se pikërisht këtu, pikërisht në vizionin që ende ngel ëndërr e njerëzimit, qëndron misteri i të qenit mit i jetës dhe veprës të Skënderbeut, i shtrirë gjatë pesë shekujve në Evropë dhe në botë.

Le të sjellim ndërmend figura dhe personalitete të shquara, nga më të shquarat nga e kaluara jonë shqiptare, por edhe nga ajo Ballkanike, dhe do të bindemi për një të vërtetë: edhe më të merituarit, sikur kanë nga një njollë të rizbuluar apo të ngjizur njësoj, vetëm Skënderbeu mbetet i pakontestueshëm nga të gjithë. Atë nuk arriti ta zbehë asgjë. Nuk pinë ujë as vërejtjet e historianëve drejtuar Marin Barletit dhe shumë autorëve të historisë së Skënderbeut për qëndrim panegjirist ndaj heroit. Prandaj nuk u ndërpre ky vizion mitizimi letrar që nga të mëdhenjtë De Rada dhe Naim Frashëri, e deri te Ismail Kadare. Nuk bënë efekt as gërmimet dashakeqe në rrënjët

gjenealogjike të Skënderbeut dhe Kastriotëve përgjithësisht. As krushqitë e tij me princërit sllavë. Nuk bënë punë as akuzat e llojit se lufta naive dhe e vetmuar e Gjergj Kastrioti-Skënderbeut kundër Perandorisë Osmane e përgjysmoi trupin kombëtar shqiptar, duke e zhvendosur atë pas vdekjes së vet, bashkë me elitën shqiptare të kohës në Itali. Nuk iu vesh asgjë prej gjëje, meqë këto duke mbetur i admiruar, i qartë dhe i pastër si kristal, nëpër gjithë sfidat e historisë...

Le ta shohim bie fjala Ballkanin e sotëm, e në daçi edhe Evropën (e bashkuar) të kapluar nga një pasiguri patologjike. Njerëzit thjeshtë sikur s'kanë mekanizma për t'u mbrojtur as edhe nga agresiviteti i pranishëm madje edhe në tryezën e drekës familjare: sikur çdo gjë e servuar gracka vdekjeprurëse; njerëzit nuk kanë mekanizma për t'u mbrojtur as nga qielli i kthjellët e i kaltër, që nga lart mund t'u dërgojë sëmundje vdekjeprurëse me zogjtë shtegtarë, deri dje dekoret më të shpeshta të artit poetik. Dhe në këtë pasiguri, tragjikisht mungon vizioni i para pesë shekujve i Skënderbeut për bashkim dhe integrim të pa kalkulim në mbrojtje nga e keqja, që më shumë se kurrë gjatë historisë po e kërcënon njerëzimin. Prandaj sikur ndjejmë nevojë të besojmë në mitin Skënderbe, këtu në hapësirën ballkanike, ku njerëzit i nxit dhe ushqen me revoltë dhe fobi patologjike bie fjala, vetëm prania e gjuhës së tjetrit, qoftë ajo edhe si një mbishkrim në shenjat e trafikut për orientimin e rrugës...

Dua të besoj se pikërisht ashtu si në të kaluarën evropiane gjatë pesë shekujve, që sa herë kanosej ndonjë rrezik i brendshëm apo i jashtëm i saj, gjallërohej figura e Skënderbeut mit dhe fakt historik, ashtu siç me të drejtë i frymëzoi në krijimtarinë me qindra shkrimtarë dhe artistë, disa nga më të mëdhenjtë në kulturën evropiane dhe botërore, po ashtu do të vazhdojë të rrezatojë edhe në të ardhmen jeta dhe veprimtaria e tij.